



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0232

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Poterqoi - Anëtar, Vjosa Gradinaj - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) NTP “Beni” , me seli në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi i Komunes së Prishtinës, me datën 07.06.2023, morri këtë:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht, si e bazuar ankesa e OE NTP “Beni” me nr. 2023/0232 , e datës 24/04/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi i Komunes së Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik NTP “Beni” me seli në Suharekë.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 09.02.2023, Kuvendi i Komunes së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për Kontratë. Me datë 07.04.2023, AK Kuvendi i Komunes së Prishtinës, ka

publikuar Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës" me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, ku është rekomanduar për kontratë GOE "Commerce -Kosova" sh.p.k& N.SH.H. Zona Park me seli në Prishtinë.

Me datë 12.04.2023, Operatori Ekonomik NTP "Beni" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK- Kuvendi i Komunes së Prishtinës, me datë 13.04.2023, AK Kuvendi i Komunes së Prishtinës, eka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 07.04.2023.

Me datën 24.04.2023, Operatori Ekonomik NTP "Beni", ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 232/2023, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Sherbim, vlera e parashikuar e kontratës: është 284,836.50€

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 07.05.2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 22 maj 2023 AK Kuvendi i Komunes së Prishtinës, ka deklaruar se nuk pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE NTP "Beni", ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 07.05.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE "NTP "Beni", të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 07.04.2023, dhe lënda të kthehet në rivlerësim (*njoftimi për dhënie të kontratës*).

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishtë e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklaramit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, ka gjetur mbështetje në raportin e ekspertizës përveç pikave që do të shtjellohen si më poshtë e poashtu përgjigjet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet 1 2 dhe 3 si dhe përgjigjet e tjera që drejtohen ndaj dispozitave ligjore, për faktin se janë përgjigje që nuk ndërlidhen me veprimet/procedurat apo çështjet direke të këtij aktiviteti, por janë pretendime ndaj dispozitave ligjore, andaj bazuar në konstatimin përfundimtar të panelit shqyrtues si dhe shpjegimet që do të jepen si më poshtë mund të kuptohet dhe të arrihet në përfundimin se në relacion me veprimet e ndërmarra të AK-së, cilat dispozita të LPP-së konstatohet se bien ndesh në harmoni me konstatimet e panelit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet ankimore si objekt shqyrtimi i kësaj ankese, paneli shqyrtues konstaton se si çështje kyçe përcaktuese që sollën deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi ishin çështjet e ngritura nga OE ankues mbi eliminimin dhe pretendimet ndaj përgjegjshmërisë se tij si dhe pretendimet ankimore ndaj OE të rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe të gjeturat e ekspertit, është evidentuar se OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet prokurimi përveç pikave tjera edhe për faktin se nuk ka vendosur çmime në një pjesë të madhe të tabelës së çmimeve, që paneli shqyrtues konstaton se sipas legjislacionit në fuqi mos-vendosja e çmimit në ofertë përmban veprim që shkakton refuzimin e ofertës dhe klasifikohet si ofertë e papërgjegjshme, lidhur me këtë, OE ankues ka pretenduar se kanë ngarkuar në ofertë çmimet dhe pretendon se faji mund të jetë tek AK apo gabim teknik, lidhur me këtë, PSH konstaton se OE ankues përveç njoftimeve në OSHP dhe KRPP nuk ka ofruar prova fakte dhe argumente të mjaftueshme se një palë e tretë ka mundur të jetë shkaktar i vendosjes së përshkrimit të çmimeve në mënyrë të tillë, në ofertën e OE ankues nga PSH është evidentuar se në tabelën e përshkrimit të çmimeve mungon një pjesë e madhe e çmimeve të ofruara nga OE ankues, andaj duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, konkretisht në nenin 10.1 të udhëzuesit nr.001/2023 për prokurimin publik të KRPP-së, në rastet kur mungon çmimi tenderi duhet refuzuar pa kërkuar sqarime, kështu që rrjedhimisht PSH konstaton se OE ankues është eliminuar nga ky aktivitet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, andaj rrjedhimisht PSH nuk ka shqyrtuar pretendimet tjera ankimore të OE ankues lidhur me përgjegjshmërinë e tij për faktin se edhe sikurse ato të ishin të bazuara nuk do të ndryshonte rezultatin përfundimtar të vendim-marrjes, andaj lidhur me këtë aktivitet prokurimi PSH konstaton se OE ankues është i papërgjegjshëm duke u bazuar në të thënat si më sipër.

Lidhur me pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, përkatësisht pretendimi nr 5, pika 1, ku OE ankues pretendon se te përshkrimi i çmimit ka gabim në kalkulim që e tejkalon normen e lejuar +-2% nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, lidhur me këtë bazuar në shkresat e lëndës, PSH ka evidentuar se ky aktivitet është paraparë që të ketë kohëzgjatjen e kontratës prej 15 muaj, ndërsa në tabelën e përshkrimit të çmimit nuk ishte bërë

korrigjimi ku nga tre kapituj vetëm kapitulli i parë (paramasa e sipërfaqeve të brendeshme) është në harmoni me korrigjimet e bëra në DT, kurse dy (2) kapitujt (paramasa e sipërfaqeve të jashtme dhe paramasa për shpenzime hixhienike) kanë mbetur pa u korrigjuar lidhur për cilët figuron 24 muaj, lidhur me këtë duke qenë se aktiviteti sipas vlerës së parashikuar dhe korrigjimeve të bëra e poashtu në DT saktësohet se parashikohet periudha 15 mujore e kontratës, përveç tjerash poashtu është evidentuar se në përshkrim të çmimeve, në ofrën e OE të rekomanduar, përkatësisht në kapitullin 1 shihet se mirëmbajtja e sipërfaqeve të brendeshme është me çmim total mujor 11,491.18€ kurse te rikapitullimi është bërë jo me këtë çmim por me çmim tjetër në vlerë prej 11,551.18€, andaj gjatë procedurave të rivlerësimit, PSH konstaton se mbetet në përgjegjësinë e AK të evidentojë, kalkulojë si dhe si rrjedhojë sipas të të gjeturave të përmirësuesit gabimet aritmetike konform legjislacionit në fuqi, konkretisht konform udhëzuesit nr.001/2023 për prokurimin publik si dhe dispozitave të LPP-së që përcaktojnë procedurat e korrigjimit të çmimeve siç parashihet me nenin 59 dhe 72 të LPP-së përmes Letrës Standarde B49 për Llogaritje të gabuar, duke u bazuar në kërkesat e DT.

Lidhur me pretendimin nr 5, pika 2 ku OE ankues pretendon se se certifikatat e punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë janë të një kompanie tjetër jo të GOE të cilët kanë ofertuar për këtë tender, eksperti shqyrtues ka potencuar se OE ankues ka ngritur pretendimin lidhur me kërkesën nr.2 tek kërkesat e përshtatshmërisë me të cilën saktësohet se : a) *Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar sipas standardeve nderkombetare te menaxhimit te cilesise ne lemin e pastrimit te objekteve, me ISO Certifikate 9001 2015 (valide).* b) *Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve nderkombetare te menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, ne lemine e pastrimit te objekteve OHSAS Certifikate 45001 2018 (valide).* c) *Operatori duhet te jete i certifikuar sipas standardeve nderkombetare te menaxhimit te mjedisit, ne lemine e pastrimit te objekteve ISO Certifikate 14001 2018 (valide).* Iso standard per menagjimin e sigurise dhe shendetit ne pune. ndërsa duke u bazuar në pretendimin ankimor, PSH konsideron se pretendimi është ngritur mbi kërkesën tjetër (OE ankues nuk ka potencuar se cilës kërkesë i referohet), andaj duke qenë se kjo kërkesë i referohet Operatorëve ekonomik (në kontekstin e kërkesës së certifikatave ISO dhe tjera), ndërsa kërkesa tjetër lidhur me certifikata është si në vijim: 3. *Operatori Ekonomik duhet te posedoj minimumin (5) punetor (staff) te certifikuar per siguri dhe shendet ne pune ne perputhshmeri me Ligjin Nr.04 L-161 sipas organogramit te kompanise.* ndërsa si dëshmi: 3. *Te deshmohet me kopje te certifikatave valide dhe organogrami te kompanise (kopje),* lidhur me këtë PSH konstaton se duke qenë se në kërkesën e lartpërmendur nuk kërkohet në mënyrë decitive kontrata, listë e punëtorëve apo parakontrata me ta, si dhe për faktin se është evidente se në brendësi të certifikatave si punëdhënës figuron një kompani tjetër, PSH konstaton se në këtë rast AK mund të kërkojë sqarime shtesë duke u bazuar në nenin 72 si dhe 52 paragrafi 7 i LPP-së.

Lidhur me pikën 3, në përgjigjen kundrejt pretendimit nr 5, ku OE ankues ka ngritur çështjen e përmbushjes së kriterit ku OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë pastrim në vlerë minimale prej 300.000,00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit, PSH konform raportit të ekspertizës këto pretendime i klasifikon si të pabazuara, por gjatë procedurave të rivlerësimit, mbetet në përgjegjësinë e AK-së që vërtetimi si dhe sigurimi i informacioneve shtesë të zhvillohet konform neneve 72 si dhe 52, paragrafi 7 i LPP-së.

Lidhur me pikën 4, në përgjigjen kundrejt pretendimit nr 5, ku OE ankues ka ngritur çështjen e përmbushjes së kriterit ku OE nuk ka dorëzuar deklaratat mbi formimin e konzorciumit apo krijimin e grupit të operatorëve ekonomik siç parshihet ne piken 11.1 të DT, PSH këtë pretendim

konform raportit të ekspertizës e klasifikon si të pa-bazuar për faktin se pas analizimit të shkresave të kësaj lënde, krahas shpjegimeve të dhëna në raportin e ekspertizës, në shkresat e lëndës figuron Marrëveshja e Konzorciumit e lidhur mes subjekteve afariste pjesëmarrëse në këtë aktivitet (e nënshkruar dhe e vulosur). Kjo marrëveshje në parim përmban të gjitha tiparet e një akti kontraktues sipas pikës 11.1 të DT, me efekt juridik mes palëve, poashtu vlen të theksohet se duke u bazuar në praktikën dhe standardin e deritanishëm, është lehtë e evidentueshme se pothuajse shumica e OE pjesëmarrës në AP në vendin tonë dorëzojnë deklaratat e tyre në një dokument të vetëm siç është marrëveshja e konzorciumit, kjo për faktin se nuk ka ndonjë dokument standard me të cilin saktësohet se këto deklaratat duhet të jenë të veçanta apo të përfshira në një dokument të vetëm.

Lidhur me përgjigjen në pretendimin nr 7 me të cilin OE ankues pretendon në çmime abnormalisht të ulëta, lidhur me çështjen e ngritur, objekt i kësaj ankese, vlen të theksohet se qëllimi primar i hartimit të legjislacionit që përkufizon dhe përcakton procedurat e çmimeve jo-normalisht të ulëta është devijimi i mundësive të manipulimit të çmimeve përmes ofertave jo-korrekte me çmime jo të tregut, kështu si pasojë duke mundësuar diskriminimin e OE-ve të cilët konkurrojnë me çmime tregu e të tilla të zakonshme, gjë që nga praktika e deritanishme këto çështje janë hasur tek kontratat kornizë, e sidomos kur sasitë indikative nuk janë të ditura dhe ofertohej me sasi 1 për secilin pozicion, me poentim dhe peshim të çmimeve ku caktohet pesha e vlerësimit të tenderit, etj.

Paneli Shqyrtues konstaton se duke u bazuar në të dhënat e këtij aktiviteti, ky aktivitet është i llojit të procedurës së hapur, dhe me qenë se kemi sasi indikative për secilin pozicion duke ditur sasitë e produkteve që ofertohej, PSH konstaton se veprimet e ndërmarra dhe sqarimet e ofruara nga OE ankues arsyetojnë ofertën e tij në aspektin përmbajtësor poashtu duke konsideruar ofertat e OE tjerë pjesëmarrës që janë të përafërta, andaj PSH konstaton se lidhur me këtë, OE ankues nuk ka ofruar dëshmi argumente dhe të dhëna konkrete që dërgojnë të vërtetimi i pretendimit apo klasifikimi e tij si i bazuar, ndërsa mbete në diskrecion e AK-së (sipas dispozitave të LPP-së) që në këtë rast, duke pasur parasysh instrumentet ligjore që mund ti përdorë para dhe përgjatë implementimit të kontratës, siç janë rritja e sigurimit të ekzekutimit sipas RRUOPP, Neni 30.4, menaxhimi i saj sipas kriterëve standardeve dhe sasive të përcaktuara paraprakisht, e poashtu bazuar në çmimet e ofertuara të krijojë bindjen se oferta e OE të rekomanduar nuk ka hapësirë manipulimesh si dhe krijim të vështirësive në implementim të kontratës, e poashtu aplikimi i nenit 61 LPP-së përgjatë procedurave të rivlerësimit.

Andaj përfundimisht duke u bazuar nga të gjitha që u thanë si më sipër, PSH konstaton se është arritur deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ku në këtë rast është konstatuar nga ana e panelit se OE ankues nuk ka arritur të dëshmojë dhe vërtetojë përgjegjshmërinë e tij, ndërsa kundrejt OE të rekomanduar ka ngritur pretendime që sipas panelit mund të aplikohen nenet 72 si dhe 52, par 7 i LPP-së, të cilat janë lënë në përgjegjësinë e AK-së që si veprime të ndërmerren përgjatë procedurave të rivlerësimit.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - NTP " BENI "**
- Arkivës së OSHP-së: